- STIHP
dt 06.02.2026

Nr. 594 Prot
Date 06.02.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË

Korçë, më 30.01.2026

**SHPALLJE VENDIMI**

**Drejtuar : Bashkia Maliq**

Për shtetasen Fatma Sulejmani me adrese : Blloku nr. 4 Maliq

Bashkëlidhur po ju dërgojmë shpalljen për vendimin civil nr. 903 dt. 17.11.2025 te Gjykates se Shkalles se Pare te Juridikisonit te Pergjithshem Korce, për t'u afishuar nga ana Juaj njoftimi me shpallje me afat *20 ditor*, pasi deftesa e komunikimit eshte kthyer me shenimin " larguar ..." dhe pas afishimit kjo shpallje të na kthehet e konfirmuar me vulë e firmë, në gjykatë.

**KANCELARE**
**Geralda Kasuli**

U afishua sot në datë ----------
Per : Bashkine Maliq
(emër, mbiemër, firmë)

31

Scanned with CamScanner

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM**
**KORÇË**

**Nr.Regj.Them. 21001-00755-41-2025 (1610)** **Nr. Vendimi 41-2025-3820 (903)**
**Datë Regj. 03.07.2025** **Datë Vendimi 17.11.2025**

# V E N D I M
# "NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë e përbërë nga:

**GJYQTARE – EDA (GJOVARI) DIKO**

asistuar nga sekretare gjyqësore Matilda Tasellari, në Korçë sot me datë 17.11.2025, mori në shqyrtim në seancë pajtimi çështjen civile me nr.regj.them. 21001-00755-41-2025 (1610), datë regj. 03.07.2025, që i përket:

**PADITËS:** Ilir Sulejmani, i biri i Gurali dhe Fiqirete, i datëlindjes 22.11.1980, lindur dhe banues në Maliq, me adresë : Blloku nr.4, me adresë njoftimi : zyra e av.Teuta Shkëmbi e ndodhur në rrugën "Myslym Shyri", pall.nr.8, shkalla nr.3, kati 1 Tiranë, me shtetësi shqiptare, me nr.personal I01122129I, përfaqësuar me prokurën e posaçme nr.658 rep., nr.393 kol., datë 04.06.2025 nga avokatja e Dhomës së Avokatisë Tiranë Teuta Shkëmbi, me nr.licence 9919 dhe Nipt.L81825012J.

**E PADITUR:** Fatma Sulejmani, e bija e Fadil dhe Adivije, e datëlindjes 16.05.1987, lindur në Tiranë dhe banuese në Maliq, me adresë : Blloku nr.4, me shtetësi shqiptare, me nr.personal I75516072B.

**OBJEKTI:** Zgjidhja e martesës mes paditësit dhe të paditurës.
Fëmijët t'i lihen për rritje dhe edukim paditësit.
E paditura të marrë mbiemrin para martesor "Hyseni".

**BAZA LIGJORE:** Nenet 153, 154, 154/a, 156 të Kodit të Procedurës Civile, nenet 129, 132 të Kodit të Familjes,



Scanned with CamScanner

Gjykata pasi çeli seancën e pajtimit të datës 17.11.2025, si konstatoi që palët nuk ishin paraqitur,

**VËREN:**

Se paditësi Ilir Sulejmani i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me kërkesëpadinë kundër të paditurës Fatma Sulejmani, me objekt: *"Zgjidhja e martesës mes paditësit dhe të paditurës. Fëmijët t'i lihen për rritje dhe edukim paditësit. E paditura të marrë mbiemrin para martesor "Hyseni"."*.

Në seancën e pajtimit të datës 17.11.2025 paditësi Ilir Sulejmani nuk u paraqit. Paditësi kishte dijeni rregullisht për datën dhe orën e gjykimit nga fletëthirrja e dërguar nga gjykata në adresën për njoftimin e akteve sipas kërkesëpadisë: zyra e av.Teuta Shkëmbi e ndodhur në rrugën "Myslym Shyri", pall.nr.8, shkalla nr.3, kati 1, Tiranë. Gjykata hetoi në lidhje me shkaqet e mosparaqitjes të paditësit dhe rezultoi se paditësi Ilir Sulejmani nuk kishte paraqitur ndonjë shkak të arsyeshëm për mosparaqitjen.

Në nenin 135/1 të Kodit të Familjes parashikohet shprehimisht se: *"Në rast se në seancën e pajtimit nuk paraqitet paditësi, ndonëse ka pasur dijeni rregullisht, gjyqtari i vetëm vendos pushimin e gjykimit të çështjes."*.

Gjykata e ndodhur në këto rrethana, ndërpreu vazhdimin e mëtejshëm të seancës së pajtimit dhe konkludoi në pushimin e gjykimit të çështjes. Marrja e vendimit të pushimit përligjet me faktin se paditësi nuk u paraqit në gjykim në seancë pajtimi pa shkak të arsyeshëm.

Në kushtet e mësipërme, mosparaqitja e paditësit në seancën e pajtimit datë 17.11.2025 pa shkak të ligjshëm në zbatim të nenit 135/1 të Kodit të Familjes dhe nenit 299 gërma "ç" të K.Pr.Civile sjell si pasojë pushimin e gjykimit të çështjes civile.

**PËR KËTO ARSYE:**

Gjykata bazuar në nenin 135/1 të K.Familjes dhe nenet 127, 299/ç, 301, 444 të K.Pr.Civile;

**VENDOSI :**

- Pushimin e gjykimit të çështjes civile me nr.regj,them. 21001-00755-41-2025 (1610), datë regj. 03.07.2025, që i përket palëve ndërgjyqëse: paditës Ilir Sulejmani, e paditur Fatma Sulejmani, me objekt: *"Zgjidhja e martesës mes paditësit dhe të paditurës. Fëmijët t'i lihen për rritje dhe edukim paditësit. E paditura të marrë mbiemrin para martesor "Hyseni"*.



Scanned with CamScanner

- Shpenzimet gjyqësore siç janë kryer.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, brenda 5 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar paditësit Ilir Sulejmani dhe të padituresë Fatma Sulejmani.

U shpall në Korçë, sot në datë 17.11.2025.

**SEKRETARE**
**MATILDA TASELLARI**

**GJYQTARE**
**EDA (GJOVARI) DIKO**



Scanned with CamScanner